



TE PUNOSH NE SIGURI TE PUNOSH NE
SIGURI TE PUNOSH NE SIGURI TE PUNOSH NE
SIGURI TE PUNOSH NE SIGURI TE PUNOSH NE
SIGURI TE PUNOSH NE SIGURI TE PUNOSH
NE SIGURI TE PUNOSH NE SIGURI



SISTEMI I PARANDALIMIT TE RREZIQEVE NE KANTJERE: NORMATIVAT DHE MASAT QE DUHEN MARRE.

Parandalimi i rreziqeve te aksidenteve ne pune eshte disiplinuar, ne te gjitha Shtetet anetare te Bashkimit European, me normativa specifike e masa qe duhen marre per te mbrojtur shendetin dhe sigurine e punetoreve. Ne Itali, ligji kryesor mbi kete ceshtje, eshte Dekreti Legjislativ **nr. 626/94**, qe parashikon, per **te gjitha aktivitetet prodhuese** ne te cilat gjendet qofte edhe nje i vetem punetor i punesuar, rregullat qe duhen respektuar **per mbarevajtjen e nje sistemi parandalimi ne vendet e punes.**

Per aktivitet qe permbajne rreziqe specifike, normativa te tjera i shtohen atyre qe parashikon D.Lgjs.626/94: ne kete rast Dekreti Legjislativ n.494/96 qe disiplinon masat qe duhen marre per shendetin dhe sigurine ne kantjeret e perkohshme dhe te levizshme. Sistemi i parandalimit ne normativat, e permendura ketu, parashikon nje mbarevajtje globale te shendetit dhe sigurise qe duhet realizuar nepermjet:

- Analizes e vleresimit te rreziqeve per sigurine e shendetin ne pune, qe nga casti i projektimit, per cdo faze te ndertimit edhe gjate realizimit te ketyre projekteve;
- Gjendjen e masave te sigurimit per kolektivin (ndihma e pare e ndihma e shpejte; kunder zjarrit; mbarevajtja e urgjencave; etj.) per te eleminuar ose zvogeluar rreziqet dhe per te garantuar efikasitetin (informim e edukim i punetoreve) dhe rendimentin (manutencion e kontroll);
- Perdorimit te shenjave te sigurise dhe/ose te shendetit per rreziqet qe mund te menjanohen ose te zvogelohen nepermjet masave te parandalimit;
- Perdorimit te mjeteve te mbrojtjes personale (helmetat; rripat e sigurimit; kufjeve kunder zhurmes; syzeve per mbrojtjen e syve; kepuce kunder aksidenteve; etj.) nga punetoret (qe jane instruktuar e stervitur ne menyre te mjaftueshme per perdorimin e tyre) per rreziqet qe nuk mund te parandalohen ne menyre tjeter dhe kontrolli per perdorimin e rregullt te tyre;
- Garantimit te nje ambjenti pune te sigurt duke parashikuar, per shembull, kalime trafikute te sigurta;
- Koordinimit e pjesmarrjes te te gjitha subjekteve te interesuara, ne sigurine (punedhenedesi; dhenesi i projektit qe duhet realizuar; pergjegjesi i puneve; pergjegjesi i sherbimit te parandalimit e te mbrojtjes; punetoret autonome e punetoret e punesuar, nepermjet perfaqesuesit te tyre per sigurine).



TE DREJTAT DHE DETYRAT E PUNETORIT

Punetori ka te drejte:

- Te marre **informacion** (nepermjet komunikimeve te drejtperdrejta te cilave mund ti shtohen, meqe kane efikasitet me te larte, format e tjera te informimit, me te zakonshme te ndermarrjes, per shembull: lajmerimet e letrat qe vihen ne tabelat e lajmerimeve, etj.) dhe edukimi per masat e parandalimit qe merren per detyren qe i eshte dhene punetorit dhe me ne pergjithesi, per procedurat qe duhen kryer ne rast rreziku madhor o urgjence;
- Te verifikoje nepermjet **perfaqesuesit te vet per sigurine** aplikimin e masave te sigurise e te mbrojtjes se shendetit;¹
- **Te largohet** nga vendi i punes ne rast rreziku madhor e te menjehershem qe nuk mund te evitohet;
- **Te refuzoje** - pervec rasteve te jashtezakonshme e me kerkese te motivuar - qe te rifilloje aktivitetin e punes ne situaten ne te cilen vazhdon te jete nje **rrezik madhor e i menjehershem**.

Pervec kesaj, ne rastet ne te cilat kryhet nje aktivitet qe permban rrezike profesionale te cilat jane objekt i vigjilances shendetesore nga ana e mjekut kompetent, punetori ka te drejte te:

- Te informohet rreth permbajtjes se **vizitave e analizave mjekesore**, per rezultatin e tyre dhe te marre nje kopje te karteles mjekesore ne rast se largohet nga puna;
- Ti drejtohet Organizmit te vigjilances duke patur gjykimin e pershtatshmerise se nje veprimi te tille nga ana e mjekut kompetent.

¹ Perfaqesuesi per sigurine ka funksionin e "garantit" te te drejtave te punetoreve per sa i perket sigurise dhe **zgjidhet ose emerohet nga punetoret** me menyra te ndryshme sipas numrit te punesuareve te ndermarrjes. **Ne ndermarrjet me deri ne 15 te punesuar** mund te zgjidhet drejt per se drejti nga punetoret ne rrethin e tyre ose zgjidhet nje nga perfaqesuesit e sindakates ne ndermarrje, nese gjendet, ose zgjidhet nje per disa ndermarrje per territorin apo per ate sektor prodhimi; **ne ndermarrjet me me shume se 15 te punesuar** duhet te zgjidhet ose te emerohet nga punetoret ne rrethin e perfaqesuesve te sindakates ne ndermarrje dhe vetem ne mungese te ketyre perfaqesuesve zgjidhet nga punetoret e ndermarrjes nga gjiri i tyre.



Ndersa, per sa i perket detyrimeve, punetori ka **detyre** te:

- Te kujdeset per sigurine dhe shendetin e tij e te personave te tjere qe ndodhen ne vendin e punes, sipas informacioneve qe ka marre, sipas instruktimit qe i eshte dhene, sipas kompetencave qe ka e sipas aftesisse e kushteve te shendetit te tij;
- Te perdore ne menyre te drejte mjetet e mbrojtjes personale (helmeta, dorezat, kufjet, kepuccet kunder aksidenteve, etj.) qe i jane vene ne dispozicion, sipas instruksioneve qe i jane dhene, edukimit qe i eshte bere dhe stervitjes eventuale qe mund te kete bere;
- Te perdore ne menyre korrekte mjetet e sigurise kolektive, e pervec ketyre edhe makinerite, aparatet, mjetet e ndryshme, substancat e **preparatet e rrezikshme**, per te evituar qe perdorimi i tyre i gabuar te mund te shkaktoje deme shendetit e sigurise personale e te personave te tjere qe gjenden ne vendin e punes;
- Te lajmeroje menjehere eprorin e tij per funksionimin e keq ose per mungesat e mjeteve te sigurise me te cilat duhet te jene te pajisur, e pervec kesaj, te lajmeroje per cdo rast rreziku per sendet ose per personat, qe ndodh ne vendin e punes (per shembull: zjarr, shperthim, aksident, ndihet keq, etj.) e qe ai merr vesh;
- Te mos modifikojte çaktivitete, pa autorizim te shprehur, mjetet e sigurise ose shenjat ose mjetet e kontrollit;
- Te impenjohet drejt per se drejti, sipas kompetencave e mundesive te tija, per te eliminuar ose per te kufizuar, ne rast urgjence, situatat e rrezikut, dhe nga ana tjeter te lajmeroje, sapo te jete e mundur, Perfaqesuesin e punetoreve per sigurine;
- Te mos refuzoje - pervec shkaqeve te motivuara - emerimin e tij si pergjegjes per kryerjen e masave te ndihmes se shpejte, shpetimit, luftes kunder zjarrit dhe veprimeve ne urgjenca;
- Ti permbahet rregullave e instruksioneve qe i jane dhene me qellim mbrojtjen personale e kolektive;
- Te beje vizita mjekesore (parandaluese dhe/ose periodike) sipas gjykimit te mjekut kompetent dhe/ose te Organit te Vigjilances;
- Te kontribuojte per kryerjen e te gjitha detyrimeve qe i jane vene nga ana e autoriteteve kompetente ose qe sidoqofte jane te nevojshme per te mbrojtur shendetin e per sigurine e punetoreve gjate punes.



REFERENTET PER SIGURINE

Punetoret ne kantjere, per ceshtje qe kane te bejne me shendetin dhe sigurine, duhet te njohin emrat dhe ku ndodhen subjektet te cileve duhet ti drejtohen e ne menyre te vecante:

> per **punetoret e punesuar**:

- **Perfaqesuesin e punetoreve per sigurine**, i cili lajmerohet per probleme eventuale te sigurise, ne menyre qe ai ti paraqese **Perfaqesuesit te Sherbimit te parandalimit e te mbrojtjes** i cili eshte i emeruar nga punedhenesi;
- **Mjekun kompetent** (aty ku, vetekuptohet, ka detyrim vigjilance shendetesore), i cili lajmerohet per shqetesime shendetesore qe mund te paraqiten;

> per **punetoret e vetepunesuar (autonome)**:

- **Koordinatorin per realizimin e punimeve**, qe duhet tu paraqese atyre informacione e instruksione per realizimin e puneve ne siguri;

Pervec kesaj, te gjithë punetoret duhet te njohin emrat e Pergjegjesve per masat e parandalimit te zjarrit, te luftes kunder zjarrit, te ndihmes se pare e te ndihmes se shpejte, te evakuimit te punetoreve ne rast rreziku.

CFARE PARASHIKOHET NE RAST AKSIDENTI NE PUNE O SEMUNDJEJE PROFESINALE

Ne rast aksidenti ne pune ose semundjeje profesionale, te gjithë punetoret ne Itali, mund ti drejtohen per kurime Sherbimit Shendetesor Kombetar (Servizio Sanitario Nazionale) dhe pervec kesaj organizmave te pensioneve publike, INAL e INPS, sipas procedurave te parashikuara nga keto.

SHENJAT E SIGURIMIT

Sistemi i shenjave te sigurimit e te shendetit ne vendin e punes (edhe keto te uniformuara ne Bashkimin European dhe objekt i informimit te punetoreve nga punedhenesi), ka qellim te terheqe menjehere vemendjen per situata qe mund te permbajne rrezik ose per veprime qe duhen kryer



per te parandaluar ato. Ai parashikon, sipas rastit, nje tablele, nje ngjyre, nje shenje drite ose akustike, nje komunikim verbal ose nje xhest si shenje qe tregon nje objekt, nje aktivitet apo nje situatë te caktuar.

Meqe shenjat duhet te respektojne nje ngjyre specifike sipas kuptimit qe ka, ketu me poshte riprodhohen disa shembuj qe shpesh paraqiten ne kantjere, dhe qe te **gjithe** punetoret **duhet** ti njohin.

Shenja ndalimi

Ndalojne nje veprim apo sjellje nga e cila mund te vije nje rrezik.

Ato jane ne forme rrethi me te shkruajtura te zeza ne sfond te bardhe; bordura dhe shirit diagonal (duke u ulur nga e majta ne te djathte pergjate simbolit, me nje kend prej 45 gradesh) me ngjyre te kuqe.



Ndalohet hyrja e karelave te levizjes



Ndalohet shuarja e zjarrit me uje



Ndalohet hyrja e personave te paautorizuar

Shenja paralajmerimi

Paralajmerojne nje rrezik.

Jane ne forme trekendeshi me te shkruajtura te zeza ne sfond te verdhe e me bordure te zeze.



Ngarkesa te varura



Karela te levizjes



Rrezik pengimi

Shenjat e tregimit

Tregojne nje sjellje apo nje veprim te caktuar.

Kane forme rrethi me te shkruajtura te bardha mbi nje sfond boje qielli.



**Kepuce sigurie
te detyrueshme**



**Mbrojtje personale e
detyrueshme kunder renjeve**



**Helmete mbrojtese e
detyrueshme**

Shenja te shpetimit ose te ndihmes

Japin indikime per daljet e sigurise ose per mjetet e ndihmes ose te shpetimit.

Kane forme katrori ose drejtkendeshi, me te shkruajtura te bardha mbi nje sfond jeshil.



Kalim/dalje ne urgjenca



Drejtim per tu ndjekur



Ndihma e shpejte